



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:140152

Datë: 05.01.2024

Numri i dokumentit: 05161388

Ep.nr.187/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Sh.A.(K), me seli në B “B.K”, nr.5, Ndërtesa e E....., kati ...I, P, ndaj debitorit P (Xh) V, nga fshati T, Komuna e P, me bazë juridike përmbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat J. K, me seli në Pejë, P.nr.170/22, i datës 23.06.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 05.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit P (Xh) V, nga fshati T Komuna e P, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht, Urdhri i Përmbaruesit Privat J. K, me seli në Pejë, P.nr.170/22, i datës 23.06.2022, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 674.25 Euro.

II.REFUZOHET I PABAZUAR, pjesa tjetër e prapësimit të debitorit dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor, P.nr.170/22, i datës 23.06.2022, i Përmbaruesit Privat J. K, me seli në Pejë, në shumën prej 470.62 Euro.

A r s y e t i m

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Sh.A.(K), me seli në B “B.K”, nr.5, Ndërtesa e E....., kati ...I, P, me datë 22.06.2022, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e konsumit të energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 25.02.2019 deri me datën 11.05.2022, baza juridike borxh në vlerë prej 1.144.87€.

Përmbaruesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, me Urdhrin për Përmbarim P.nr.170/22, të datës 23.06.2022, ka lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitori me datën 04.07.2022, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor, duke theksuar se borxhi total për të cilin ngarkohem është në shumë prej 1.144.87 Euro, borxhi i krijuar 02.12.2014 e gjerë me 26.04.2021 është në shumën prej 812.05 Euro, ky borxh i krijuar është parashkruar, ndërsa sa i përket borxhit për periudhën kohore prej 1 viti, nga data 26.04.2021 deri me datë 25.05.2022, në shumë prej 332.82 Euro, borxh të cilin pranoj si të tillë por për shkak se gjendjes ekonomike nuk kam arritur që të paguaj, andaj në kuptim të nenit 360 par.1.1 të LMD-së, ku parashihet se kërkesa për furnizim me energji elektrike, gaz, ujë dhe shërbimet e mirëmbajtjes parashkruhet pas një viti, i propozoj gjykatës që ta aprovoj prapësimin dhe ta anuloj urdhrin përmbarimor.

Përfaqësuesi i kreditorit me datën 06.07.2022, ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar dhe të paargumentuar përmes asnjë prove prapësimin e debitorit. Sa i përket çështjes së parashkrimit në përgjigjen në padi është theksuar se me datën 06.11.2021 debitori ka bërë pagesë në vlerë prej 20.00 Euro, me ç’rast me pagesa vullnetare të debitorit është e mjaftueshme për tu manifestuar pranimin e borxhit-Ex Lege-ky fakt që shkakton ndërprerjen e parashkrimit dhe atë komfor nenit 368 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke i propozuar gjykatës që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi ndërsa prapësimi të refuzohet.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrit përmbarimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbarim të datës 21.06.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat J K, me seli në Pejë, me P.nr.170/22, i datës 23.06.2022, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 25.02.2019 deri me datën 11.05.2022, në shumën prej 1.144.87 Euro në emër të konsumit të energjisë elektrike.

Gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, mbi bazën e së cilës është filluar procedura përmbarimore, është dokumenti juridik i besueshëm dhe titull i përshtatshëm për përmbarim, dhe si i tillë plotëson të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP-së), që përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”.*

Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmbarim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se: *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.*

Gjykata konstaton se kreditori për një pjesë të kërkesës ka humbur afatin ligjor brenda të cilit do të mund të arkëtonte forcërisht borxhin përmes rrugës gjyqësore, saktësisht për borxhin që përfshin periudhën kohore nga data 25.02.2019 e deri më 31.12.2020, në shumë prej 674.25 euro për shkak të parashkrimit.

Kreditori propozimin për përmbarim, e ka paraqitur më datën 22.06.2022 dhe sipas vlerësimit të gjykatës, borxhi i krijuar nga ana e debitorit që nga data 25.02.2019 e deri më 31.12.2020 është parashkruar, sepse ka kaluar afati 1 vjeçar brenda së cilës kreditori ka pasur mundësi të kërkojë përmbushjen gjyqësore të detyrimit, referuar nenit 360 par.1 pika 1.1 dhe par.2 dhe par.3 të LMD-së që përcakton se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer*

për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. 3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”. Kurse neni 341 par.1 i LMD-së përcakton se “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit.”

Sa i përket rrjedhshmërisë së afatit të parashkrimit, tek kërkesat periodike siç është rasti konkret, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Si rrjedhojë, për borxhin e vitit 2019 afati ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2019, respektivisht më 31.12.2019, ndërsa i njëjti është parashkruar pas një viti gjegjësisht me 31.12.2020. Ngjashëm edhe sa i përket pjesës tjetër të borxhit të akumuluar për periudhën e specifikuar në propozimin për përmbarim, për borxhin e vitit 2020, parashkrimi ka filluar të rrjedhë me 31.12.2020, ndërsa parashkrimi ka arritur me datën 31.12.2021.

Kurse, propozimi për përmbarim nga kreditori është paraqitur me 22.06.2022, që në kuptim të nenit 360 par.1 të LMD-së, kreditori për këtë periudhë kohore, propozimin për përmbarim e ka paraqitur jashtë afatit ligjor 1 vjeçar, me ç’rast, borxhi i krijuar nga 25.02.2019 e deri më 31.12.2020, në shumë prej 674.25 euro është parashkruar.

Vendosja si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.

Gjykata konstaton se debitori detyrohet ti paguaj kreditorit shumën prej 470.62 euro për furnizimin me energji elektrike, për periudhën kohore nga 01.01.2021 e deri më 11.05.2022, për shkak se borxhi i tillë për këtë periudhë nuk është parashkruar.

Kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarim të datës 22.06.2022, e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën nga data 01.01.2021 e deri më 11.05.2022. Kjo për shkak se parashkrimi i borxhit të vitit 2021 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2021 dhe borxhi i vitit 2021 do të parashkruhej pas një viti, respektivisht me 31.12.2022, ndërsa borxhi i vitit 2022, do të arrinte parashkrimin me 31.12.2023, kurse kreditori propozimin për përmbarim e ka paraqitur me datën 22.06.2022, brenda afatit ligjor 1 vjeçar, të paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së. Paraqitja e propozimit ka ndërprerë parashkrimin e borxhit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së, që përcakton se: “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, dhe debitori detyrohet që shumën prej 470.62 euro t'ia paguaj kreditorit.

Pretendimet e kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit të debitorit pasi që faturat e rregullta të energjisë elektrike të shpenzuar për periudhën që është kërkuar në prapësim i janë lënë konsumatorit, gjykata e gjen si të pabazuar duke u mbështetur në nenin 360 par.3 të LMD-së, i cili përcakton se afati i parashkrimit “*rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë*”.

Për më tepër, edhe pretendimin e kreditorit se pagesa e bërë nga debitori me datën 06.11.2021, në vlerë prej 20.00 Euro, në emër të energjisë elektrike është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit, gjë që shkakton edhe ndërprerjen e parashkrimit gjykata e konsideron si të pabazuar në mbështetje të nenit 368 të LMD-së, i cili në paragrafët 1 dhe 2, përcaktohen se: *1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin; 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.*”, kështu gjykata e gjen si të pabazuar këtë pretendim të kreditorit përderisa nuk është vërtetuar se kemi pagesa të kësteve nga ana e debitorit pasi që një gjë e tillë mund të vjen në shprehje vetëm nëse ka marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit në këste të caktuara, ndërsa çfarëdo pagese e rregullt e bërë nga ana e debitorit nuk e nënkupton pranimin e borxhit të tërësishëm.

Që të konsiderohet se debitori e pranon borxhin e parashkruar, është situatë që e rregullon shprehimisht neni 347 par.1 i LMD-së, i cili përcakton se: “*Njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi*”. Në rastin konkret, për të konsideruar se debitori ka pranuar në tërësi borxhin e parashkruar duhet që në mënyrë të vullnetshme dhe me shkrim të pranoj dhe njoh detyrimin e parashkruar, e që në rastin konkret një pranim i tillë nga ana e debitorit nuk ka ndodhur. Në këtë drejtim, pretendimi i kreditorit është tërësisht i pabazuar.

Ndërsa, sa i përket pretendimet të debitorit të paraqitura në prapësim lidhur me pagesat e bëra përgjatë viteve prej vitit 2014 e deri me 2022, si dhe pamundësinë e pagimit të shumës së mbetur të borxhit për shkak të kushteve ekonomike, gjykata i vlerëson si jorelevante për vendosje ndryshe si dhe të pambështetura në asnjë nga shkaqet ligjore për paraqitjen e prapësimin të përcaktuara me nenin 71 par.1 të LPP-së, pasi që në ekstraktin e nxjerr nga librat afarist është e përcaktuar debitori si konsumator në të cilën në mënyrë të detajuar janë të përcaktuara shumat e detyrimeve të debitorit, koha e arritjes së tyre, pagesat eventuale, të cilat e bëjnë të kërkueshme kredinë e kreditorit.

Gjithashtu gjykata potencon faktin se procedura përbarimore, është procedurë e atillë që gjykatës nuk i lejohet shqyrtimi i fakteve materiale mirëpo vetëm shqyrtimi nëse dokumenti i besueshëm është titull juridik për fillimin e procedurës përbarimore dhe nëse urdhri për përbarim është i ligjshëm në aspektin formal. Parimi i legalitetit rigoroz formal është një ndër parimet bazë në procedurën përbarimore sipas së cilit gjykata nuk mund të lëshohet në vlefshmërinë materiale të dokumentit juridik apo në përmbajtjen e tij, por vetëm siguron nëse dokumenti juridik i besueshëm përmban kushtet ligjore formale, si përshtatshmërinë dhe përbarueshmërinë e dokumentit juridik. Andaj sipas vlerësimit të gjykatës, dokumenti i besueshëm mbi bazën e së cilës ka filluar përbarimi plotëson të gjitha kushtet ligjore si përshtatshmëria e përbarimit.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: “*gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit*”.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së dhe neni 341 par. 1 dhe nenit 360 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:140152

Ep.nr.187/2022, me datë 05.01.2024.

Gjyqtarja

Blerta KELMENDI

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.